



<b>KANS</b> KOSOVO NAVIGATION SERVICES	AGJENCIA E SHËRBIMEVE TË NAVIGACIONIT AJROR AGENCIJA ZA VAZDUSNO NAVIGACIONE USLUGE AIR NAVIGATION SERVICES AGENCY
AIR	ZYRË E ARKIVES KONFERENCOJE DËNDË OFFICES OFFICE
01	09/10/25
0696	711 LIPJAN, RKS

Titulli: F-ZYDR-005  
Versioni: 1.0  
Klasifikimi: Brendshëm  
Page: 1 of 1

Nr. 178/25  
Datë: 09/10/2025

Në bazë të nenit 16, paragrafi 2, të Ligjit Nr. 08/L-305 për Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror – KANS, si dhe nenit 4, paragrafi 4, të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ofruesit të Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Drejtori i Përgjithshëm merr këtë:

### VENDIM

#### -për caktimin e zyrtarit përgjegjës me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit

1. z. Ilir Dukolli, i emëruar në pozitën: U.D - Menaxher i Kabinetit, caktohet zyrtar përgjegjës për koordinim me Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit për çështjet e Konfliktit të Interesit dhe Deklarimit të Pasurisë në Ofruesin e Shërbimeve të Navigacionit Ajror – KANS.
2. Zyrtari përgjegjës, në pajtim me legjislacionin në fuqi ka për detyrë të koordinojë të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me deklarimin e Pasurisë dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit për të gjithë të punësuarit në KANS.
3. Me këtë vendim, shfuqizohen vendimet paraprake për caktimin e zyrtarit për Parandalim të Konfliktit të Interesit dhe për Deklarim të Pasurisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi, ditën e nënshkrimit.

### ARSYETIM

Ky vendim për caktimin e zyrtarit përgjegjës për koordinimin e KANS me APK, është nxjerrë bazuar në kërkesat ligjore për caktim të zyrtarëve përgjegjës si dhe në faktin se zyrtari aktual (z.Bazaj) për një kohë ka pasur marrëdhënien e punës të pezulluar, përkatësisht në pushim pa pagesë.

Vendimi po ashtu është i bazuar në nenin 21 të Ligjit NR. 08/L-108 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe të Dhuratave dhe Nenit 20 të Ligjit Nr. 06/L -011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, me të cilat dispozita obligohet Institucioni për caktim të zyrtarit përgjegjës.



#### Iu dërgohet:

- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit;
- Nëpunësit z. Ilir Dukolli;
- Departamentit të Burimeve Njerëzore;
- Zyrës së Arkivit.